



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), nenit 14, dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 6 lidhur me nenin 7, pika 3, lidhur me neni 9, te Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-35/2012” nenit 5, 11, lidhur me nenin 18, të Rregullorës (QRK) Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2018, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim personave fizik dhe juridik të cekur më poshtë; Ju jepet në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite, prona e paluajtshme, pasurisë shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, në **“Zona industriale” në Shirokë, **për ushtrim të veprimtarisë afariste**, sipas rekomandimit të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.**

- 1.1** Firmës **N.T.SH “A&T”** me seli në Suharekë, Rr. “Br.123” me person përgjegjës Agim Trolli nga fshati Gelancë Komuna e Suharekës, i **jepet**; parcela **Nr-2785/20**, me sipërfaqe të përgjithshëm **S=8000m²**, me destinim sipas planit rregullativ **“Depo të ndryshme materiale”**.
- 1.2** Firmës **“Swiss Storen-Muri Plast”** SH.P.K me seli në zonën industriale në Shirokë, me person përgjegjës Rifat Aliaj, nga fshati Dvoran Komuna e Suharekës, i **jepet**; parcela, **Nr-2785/63**, me sipërfaqe të përgjithshëm **S=5000m²**, me destinim sipas planit rregullativ **“Përpunimi i elementeve nga materiali i plastikës, aluminit dhe drurit”**.
- 1.3** Firmës **N.T,SH “Metal Fix”** me seli në fshatin Gelancë, me person përgjegjës Burim Devetaku nga fshati Gelancë Komuna e Suharekës, i **jepet**; parcela, **Nr-2785/66**, me sipërfaqe të përgjithshëm **S=5000m²**, me destinim sipas planit rregullativ **“Përpunimi i elementeve nga materiali i plastikës, aluminit dhe drurit”**.

Neni 2

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme fillon të rrjedh nga data, **26.09.2018**, dhe përfundon afati më datën, **25.09.2117**, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik.

Neni 3

3.1 Obligohet; Kryetari i Komunës që me **personat fizik dhe juridik përfitues të pronës së paluajtshme**, të lidh kontratë me së cilin veç e veç me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

3.2. Obligohen; përfituesit e pronave të paluajtshme të Komunës, konkretisht personat juridik dhe fizikë të cekur në neni 1, të këtij vendim, që në afat prej 10, dite nga data e miratimit të këtij vendim të sjellin për personat juridik; qarkullimin bankar dhe garancionin bankar, ndërsa për personat fizik vetëm garancioni bankar.

3.3 Nëse personat e cekur në paragrafin 2, të nenit 3, të këtij vendimi nuk e sjellin dokumentacionin e kërkuar në afatin ligjor, konsiderohet se ka hequr dorë nga shfrytëzimi i pronës së paluajtshme.

Neni 4

4.1 Obligohen shfrytëzuesit e cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që **pronën e paluajtshme** të cekur në nenin 1, të këtë vendim, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

4.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores, (QRK) Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËSNË SUHAREKË

01-Nr- 104-62571
Më datë 27.09.2018


28.09.2018



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI